

Zehadin Gashi

UDHËZUES PËR PRAKTIKËN NË FARMACI

Për Farmacistët e Sapodiplomuar

INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE ZHVILLIM FARMACEUTIK

UDHËZUES PËR PRAKTIKËN NË FARMACI

Për Farmacistët e Sapodiplomuar

1. Qëllimi i Praktikës Profesionale

Qëllimi i praktikës është të sigurojë përgatitjen profesionale dhe praktike të farmacistëve të sapodiplomuar për ushtrimin e pavarur të profesionit të farmacistit, në përputhje me standardet evropiane dhe ligjin për profesionet shëndetësore.

2. Kohëzgjatja dhe Organizimi i Praktikës

- Kohëzgjatja: 6 muaj me orar të plotë.
- Vendndodhja: Praktika realizohet në barnatore të licencuara publike ose private, nën mbikëqyrjen e një farmacisti mentor me përvojë (min. 5 vite përvoj pune).
- Përgjegjës për mbikëqyrje: Farmacisti mentor dhe institucioni i praktikës.

3. Objektivat e Praktikës

Praktikanti duhet të:

- Njohë dhe zbatojë etikën dhe legjislacionin farmaceutik.
- Zotërojë aftësi për dispenzim të sigurt e racional të barnave.
- Mësojë komunikimin profesional me pacientët dhe ekipin shëndetësor.
- Përdorë sistemet informatike farmaceutike dhe menaxhimin e dokumentacionit.
- Kuptojë menaxhimin e stokut, porosive dhe ruajtjes së barnave.
- Përfitojë njohuri për produkte mjekësore, suplemente, pajisje mjekësore dhe përgatitjen galenike.
- Përcaktojë dhe zbatojë shërbime farmaceutike si këshillimi për barnat, farmakovigjilenca dhe kujdesi farmaceutik.

4. Struktura e Praktikës

5. Roli i Mentorit

- Siguron mbikëqyrje, udhëzime dhe vlerësime të rregullta.
- Plotëson formularin e vlerësimit mujor.
- Jep rekomandime për përmirësim.
- Vërteton përfundimin e praktikës në fund.

6. Dokumentacioni që Duhet Plotësuar

- Ditari i Praktikës
- Plani Më i Aktivitetit
- Vlerësimi i Performancës
- Raporti Final i Praktikës

7. Vlerësimi dhe Përfundimi i Praktikës

- Praktikanti duhet të plotësojë me sukses të gjitha objektivat e përcaktuara.
- Pas përfundimit, institucioni jep një certifikatë të përfundimit të praktikës.
- Praktikanti është i kualifikuar për të hyrë në provimin shtetëror të licencimit -provimin profesional

8. Etika dhe Profesionalizmi

Praktikanti duhet të:

- Respektojë konfidencialitetin e pacientëve.
- Tregojë sjellje profesionale, ndershmëri dhe përkushtim.
- Tregojë gatishmëri për të mësuar dhe për të marrë përgjegjësi.

9. Burime të Rekomanduara

- Farmakopeja zyrtare
- Rregulloret e barnave dhe ligji për profesionet shëndetësore
- Manuali i praktikës së mirë farmaceutike
- Rrjetet profesionale dhe revistat farmaceutike

INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE ZHVILLIM FARMACEUTIK

STRUKTURA E PROGRAMIT (nga muaji 1 deri në muajin 6)

Muaji 1: Hyrje dhe ambientimi në farmaci

- - Prezantimi me ambientin e punës, rregulloret dhe ekipin.
- - Njohja me legjislacionin farmaceutik bazë.
- - Rregullat e ruajtjes dhe magazinimit të barnave.
- - Përdorimi i sistemit farmaceutik informatik (nëse aplikohet).

Muaji 2: Shpërndarja e barnave dhe kujdesi për pacientin

- - Aftësimi për leximin dhe interpretimin e recetave.
- - Kontrolli i dozës, ndërveprimeve dhe kundërendikacioneve.
- - Konsultimi dhe këshillimi i pacientëve për përdorimin e duhur të barnave.
- - Përdorimi i formularëve për barna me recetë të veçantë.

Muaji 3: Përgatitja e barnave magjistrale dhe galenike

- - Rregullat e përgatitjes aseptike dhe teknike.
- - Dokumentimi në fletët e përgatitjes dhe kontrolli i cilësisë.
- - Paketimi, etiketimi dhe udhëzimet për përdorim.
- - Higjiena dhe mbrojtja personale gjatë përgatitjes.

Muaji 4: Menaxhimi farmaceutik dhe logjistika

- - Menaxhimi i stokut të barnave dhe inventarizimi.
- - Regjistrimi i hyrjes/daljes së barnave.
- - Raportimi i barnave të prishura, të skaduara apo të rrezikshme.
- - Menaxhimi i porosive dhe marrëdhëniet me distributorët.

Muaji 5: Farmakovigjilenca dhe përgjegjësia etike

- - Raportimi i efekteve anësore të barnave.
- - Roli i farmacistit në promovimin e përdorimit racional të barnave.
- - Diskutimi i rasteve klinike dhe etike të zakonshme në praktikë.
- - Komunikimi me mjekë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë.

Muaji 6: Pavarësimi i punës dhe vlerësimi përfundimtar

- - Menaxhimi i situatave të përditshme pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë.
- - Përgatitja për provimin profesional (nëse kërkohet ligjërisht).
- - Vlerësimi nga farmacisti mentor dhe plotësimi i raportit përfundimtar të praktikës.
- - Dorëzimi i ditarit të praktikës.

INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE ZHVILLIM FARMACEUTIK

MATERIALI TEORIK I PRAKTIKËS PROFESIONALE

Për Farmacistët e Sapodiplomuar

1. Hyrje në praktikën farmaceutike

- Praktika profesionale është një fazë e rëndësishme në përgatitjen e farmacistit, që e aftëson atë të aplikojë njohuritë teorike në situata reale të punës. Ajo synon të zhvillojë kompetencat profesionale, etike dhe komunikative në përputhje me standardet bashkëkohore të farmacisë.
-

2. Objektivat kryesore të praktikës

- - Të përforcohen njohuritë farmaceutike përmes përvojës së drejtpërdrejtë.
- - Të mësohet përgatitja, shpërndarja dhe kontrolli i cilësisë së barnave.
- - Të zhvillohet aftësia për komunikim me pacientë dhe staf mjekësor.
- - Të zbatohet etika profesionale dhe të njihet legjislacioni farmaceutik.

3. Fushat kryesore të përfshira në praktikë

- - Farmaci komunitare dhe hospitalore
- - Përgatitja magjistrale dhe galenike
- - Menaxhimi i barnave dhe logjistika farmaceutike
- - Farmakovigjilenca dhe raportimi i efekteve anësore
- - Komunikimi farmaceutik dhe edukimi i pacientit

4. Përgatitja magjistrale dhe kontrolli i cilësisë

- Farmacisti duhet të njohë procedurat e përgatitjes së barnave sipas formularit farmaceutik dhe standardeve të GMP-së. Ai duhet të zbatojë teknika të pastra, të dokumentojë çdo hap dhe të kontrollojë cilësinë përpara dorëzimit të pacienti.
-

5. Dokumentacioni profesional gjatë praktikës

- - Fletët e përgatitjes së barnave magjistrale
- - Regjistrat e barnave dhe evidenca e hyrje-daljeve
- - Formularët për efektet anësore dhe farmakovigjilencën
- - Ditari i praktikës dhe vlerësimi periodik nga mbikëqyrësi

6. Etika dhe komunikimi profesional

- Gjatë praktikës, farmacisti i ri duhet të respektojë të drejtën e pacientit, të ruajë konfidencialitetin, të japë këshilla të sakta dhe të kontribuojë në përmirësimin e kujdesit shëndetësor përmes bashkëpunimit me mjekë dhe infermierë.

7. Vlerësimi i praktikës profesionale

- Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe përfshin performancën teknike, etikën, komunikimin dhe nivelin e pavarësisë. Ditarët dhe raportet mujore janë baza për përgatitjen e raportit përfundimtar të praktikës.
-